



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 242/5 Prot.

Tiranë, më 12.06.2023

Lënda: Njoftim

OPERATORIT EKONOMIK "AVIA CENTER" SHPK

Adresa: Rruga "Arkitekt Kasemi", Pallati Nr. 52, Apartamenti 2, 1015, Tiranë.

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të kërkesës së Bordit të Mbikqyrjes Publike (në vijim "AK"), me shkresën Nr. 2422/5 Prot., datë 30.05.2023, ka nisur procedimin administrativ ndaj operatorit ekonomik "Avia Center" shpk, për përjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik".

Gjithashtu, me këtë shkresë ju është nisur dokumentacioni i administruar për këtë çështje, në adresën e shoqërisë tuaj. Shkresa Nr. 2422/5 Prot., datë 30.05.2023 nuk ka shkuar në destinacion dhe është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare, me justifikimin "Larguar".

APP ka rinisur shkresën e sipërcituar në adresën e operatorit ekonomik "Avia Center" shpk sipas informacionit të dërguar nga AK dhe Ekstraktit të Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në datë 05.06.2023, e cila është kthyer përsëri nga shërbimi postar, me të njëjtin justifikim.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik, APP njofton shoqërinë tuaj se, në bazë të parashikimeve të nenit 45 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", rezervoni të drejtën për t'u njohur me provat e administruara në kuadër të procedimit administrativ të nisur ndaj shoqërisë tuaj, duke dërguar kërkesën me shkrim, **brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i këtij njoftimi në faqen e APP**, pasi në të kundërt APP do të vijojë procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rejda Kashta

